

De Biazi: Enderrojme te shkojme ne France

nga AlbaniaSoccer
E enjte, 24 Tetor 2013 22:50



Sapo ka firmosur kontraten, Xhani De Biazi ka folur per mediat shqiptare duke shpalosur objektivat per sezonin e ri. “Ne te gjithë mbetem te zhgenjyer ne fund te elimatoreve duke patur parasysh startin shume pozitiv, ku arrihem pertej pritshmerive. Besoj se te gjithë ne perjetuam nje enderr se mund te shkonim atje ku ne fillim as qe e conim nepermend. Pjesa e dyte na la nje shije te hidhur. Ne edicionim e ardhshem do te te bazohemi ne nje grup pak a shume te konsoliduar dhe nuk do te na duhet te bejme rinovime te shumta. Duhet te rritemi me shume si skuader dhe te synojme te arrijme atje ku te gjithë enderrojme. A do te shkojme ne France? Ky eshte objektivi qe kemi te gjithë. Ne koken dhe zemren tone duhet te ekzistojë kjo deshire, por nga ana tjetër duhet te krijojme ambientin e duhur, edhe me ndihmen tuaj, qe te ecim perpara me shume qetesi”, ka thene De Biazi qe me pas eshte ndalur te flase edhe per Adnan Januzaj. “Do te punoj ne bashkepimim me Federaten, duke e patur te qarte ne koke sesi do te mund ta motivoj kete djalosh per te luajtur me Shqiperine. Sigurisht qe do ta bej nje tantative per ta bindur qe te luaje me ne. Nuk e di sesa do te mund te jem i suksesshem ne kete tentative, por sigurisht qe do ta takojme Januzajn”, ka perfunduar fjalen e tij trajneri italian i Shqiperise.